

VENDIM
Nr.442, datë 10.10.1992

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7496, DATË 4.8.1992 "PËR INVESTIMET E HUAJA"

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të neneve 1 dhe 2 të ligjit, investimet e huaja në Shqipëri mund të kryhen si investime me kapital tërësisht të huaj, me pjesëmarrje në shoqëritë, duke bashkuar kapitalet ose me forma të tjera pjesëmarrjeje, duke përfshirë edhe të drejtat intelektuale.

2. Në zbatim të nenit 3 (pika (a) e ligjit, degët me rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit dhe vlerat përkatëse minimale, mbi bazën e të cilave lëshohet autorizimi nga Këshilli i Ministrave, janë:

Industria minerare	10 mil. USD
Industria energjetike	10 mil. USD
Telekomunikacioni	5 mil. USD
Portet e aeroportet	10 mil. USD
Transporti ajror	10 mil. USD
Transporti hekurudhor	10 mil. USD
Rrugët e hekurudhat	20 mil. USD
Turizmi	20 mil. USD
nxjerrje naft/gaz	10 mil. USD
kërkim naft/gaz	10 mil. USD
përpunim naftë	10 mil. USD
industria ushtarake - tërë vlerat	
radiotelevizioni	2 mil. USD
përpunimi i arit dhe metaleve	
të tjera të çmueshme	0.1 mil.USD
Pyjet dhe ujërat	10 mil. USD

Prodhimet e lëndëve toksike, radioaktive e narkotike - tërë vlerat.

3. Organi i pushtetit lokal që lëshon autorizimin në përputhje me ligjin, është kryesia e këshillit të rrethit, që bashkëpunon me bashkitë dhe komunat, në të cilat bëhet investimi i huaj. Për qytetin e Tiranës autorizimi lëshohet nga kryetari i bashkisë.

4. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, shoqëritë e themeluara sipas ligjit shqiptar dhe që kanë selinë në Shqipëri, duhet të kërkojnë autorizim për investimet vetëm kur pjesëmarrja e kapitalit të huaj në kapitalin themeltar të tyre është mbi 50 për qind.

5. Pjesëmarrja e një investitori të huaj në krijimin e një shoqërie, e pashoqëruar me kontribut në kapital, nuk konsiderohet investim i huaj dhe për pasojë nuk kërkohet autorizim.

6. Rritja e kapitalit themeltar të një personi juridik të huaj ose të një personi juridik shqiptar që kontrollohet nga një investitor i huaj, nuk kërkon autorizim.

Në ndërmarrjet e përbashkëta, ku ortaku shqiptar është një ndërmarrje shtetërore, ortaku shqiptar duhet të ketë marrë pëlqimin e ministrisë përkatëse, para se asambleja e ortakëve të vendosë për rritje të kapitalit themeltar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në statutin përkatës.

7. Kur investitori i huaj krahas kërkesës për investim bën edhe kërkesë për krijimin e një shoqërie, ose anasjelltas, jepet vetëm një autorizim për të dyja. Organi që do të lëshojë autorizimin, përcaktohet nga shuma që investitori i huaj vë për investimin dhe krijimin e shoqërisë të marra së bashku.

8. Në zbatim të nenit 15 të ligjit për investimet e huaja me vlerë nën 50 mijë USD, zgjedhja e mosmarrëveshjeve të parashikuara në këtë nen të synohet të bëhet pranë një gjykate kompetente shqiptare dhe kjo të shënohet në autorizim, pasi të jetë rënë dakord me investitorin e huaj.

9. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë të bëjë

evidencimin e investimeve të hujaj në territorin e Shqipërisë. Për këtë lëshueshit e autorizimit, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, një kopje të tij ta dërgojnë në Ministrinë e Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi